

OBSERVATORI I EKONOMIVE TË PALIGJSHME NË EVROPËN JUGLINDORE



RISK BULLETIN

PËRMBLEDHJE E PIKAVE KRYESORE

1. Lidhjet midis politikës, etnisë dhe krimit të organizuar në veri të Kosovës.

Në mes të tetorit, policia e Kosovës hyri në qytetin e Mitrovicës në kuadër të një vargu operacionesh që kishin për synim goditjen e krimit të organizuar. Shpejt, ai që filloi si operacion i shënjestruar i agjencive ligjzbatuese u shndërrua shpejt në përplasje midis policisë dhe qytetarëve të inatosur. Veriu i Kosovës shpesh karakterizohet si vatër e krimit të organizuar, por si duket bota e krimit në veri të lumit Ibër?

2. Çfarë ndikimi mund të ketë te krimi i organizuar nisma "Ballkani i Hapur"?

Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia po bëjnë përpara duke u mbështetur në idenë e një nisme "Ballkani të Hapur" për krijimin e një zone ekonomike, e cila do të përmirësonte më tej marrëdhëniet politike dhe ekonomike dhe do të fuqizonte lidhjet kulturore midis këtyre vendeve. Përpjekjet për të nxitur rritjen e integritimit rajonal, qoftë nëpërmjet nismës "Ballkani i Hapur", qoftë nëpërmjet Tregut të Përbashkët Rajonal, duhet të shfrytëzohen edhe si mundësi për të fuqizuar bashkëpunimin rajonal midis agjencive të zbatimit të ligjit në luftën kundër krimit të organizuar.

3. Grupet kriminale në Shqipëri shfrytëzojnë gjakmarrjen.

Shoqëria shqiptare ndonjëherë portretizohet si e dhunshme për shkak të normave të saj të vrazhda kulturore, siç është gjakmarrja. Por kjo praktikë kufizohet kryesisht në veri të Shqipërisë dhe përdorimi i saj është duke u pakësuar. Pavarësisht kësaj, gjakmarrja përdoret si instrument nga grupet e krimit të

organizuar për të fuqizuar faktorin e frikës dhe është keqpërdorur nga disa azilkerkues që kanë përdorur vërtetime të rreme për të mbështetur pretendimet e tyre se janë viktime të gjakmarrjes.

4. Nismat lokale: Dialogët për qëndrueshmërinë në Ballkanin Perëndimor

Në tetor dhe nëntor, Observatori i Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore vazhdoi të zhvillonte "Dialogët për qëndrueshmërinë" në të gjashtë kryeqytetet e Ballkanit Perëndimor, ku pjesëmarrësit morën pjesë fizikisht. Diskutime të gjalla u zhvilluan në Tiranë, Beograd, Sarajevë dhe Prishtinë. Takimet ishin një mundësi ku organizatat e shoqërisë civile (OSHC) mund të mblidheshin dhe shkëmbenin pikëpamjet lidhur me veprimtaritë aktuale dhe për të diskutuar sfidat me të cilat përballen në punën e tyre. Disa prej diskutimeve më dinamike u zhvilluan midis përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe atyre të qeverisë në lidhje me mënyrën se si mund të bashkëpunojnë në mënyrë më efektive në lidhje me tema të tilla si emigracioni, korrupsioni dhe droga.

5. T'i vësh shqelmin krimit: Përdorimi i arteve marciale për të fuqizuar rininë shqiptare.

Në kuadër të serisë sonë të bisedave me përfaqësues nga OSHC-të në Ballkanin Perëndimor, të cilët janë duke fuqizuar qëndrueshmërinë lokale ndaj krimit të organizuar, ne biseduam me Elion Pukën, mjeshër i arteve marciale dhe drejtues i klubit "Vlaznia Taekwondo" në Shkodër të Shqipërisë, në lidhje me punën e tij në kuadër të përdorimit të arteve marciale për të fuqizuar të rinjtë dhe për t'i mbajtur ata larg krimit.



RRETH KËTJ NUMRI

Mirë se vini në numrin e njëmbëdhjetë të "Buletinit të rreziqeve", i cili është rezultat i punës së Observatorit të Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore ("SEE-Obs") të Iniciativës Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (GI-TOC). Si zakonisht, fillojmë me një profil të vatrës së krimit të organizuar: këtë herë me rajonin e veriut të Kosovës. Këtu shqyrtojmë se çfarë është duke ndodhur prapa retorikës politike dhe shohim më nga afër ekonominë kriminale në këtë nënrajon, sidomos kontrabandimin e mallrave të ligjshëm.

Edhe pse ka pasur shumë bujë lidhur me nismën "Ballkani i Hapur", nuk ka munguar skepticizmi. Do të shohim rrjedhojat e mundshme që ka hapja e mëtejshme e kufijve të tregjet kriminale dhe do të theksojmë nevojën për rritje të bashkëpunimit rajonal në fushën e zbatimit të ligjit. Ne paralajmërojmë se, ajo që nuk duhet bërë, të paktën në fillim, është krijimi i një tjetër organi rajonal të zbatimit të ligjit: numri i organeve të tilla është i mjaftueshëm tani për tani, në mos i tepërt. Megjithatë, ekziston nevoja për më shumë bashkëpunim dhe koordinim, të cilët mund të përmirësohen duke përdorur në mënyrë më efektive organet si procesi i Qeverisjes Integrative në rrafshin e Sigurisë së Brendshme, i cili është pjesë e përpjekjeve të BE-së për përmirësimin e bashkëpunimit në Ballkanin Perëndimor në fushën e sigurisë.

Gjithashtu, do të paraqesim edhe një pasqyrë të përgjithshme të katër dialogëve për qëndrueshmërinë, të cilët u organizuan nga Observatori në tetor dhe nëntor, pas takimit fillestar të mbajtur në shtator në Shkup. Këto takime u zhvilluan në Tiranë, Beograd, Sarajevë dhe Prishtinë duke zbatuar rregullat e institutit "Chatham House" (sipas të cilit, lejohet raportimi i informacioneve të shpalosura, por pa identifikuar burimin), prandaj është e vështirë t'i japësh lexuesit të kuptojë si është energjia në sallë ose kur zhvillohen diskutime të gjalla, sidomos ato që u zhvilluan midis përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe atyre të qeverisë. Megjithatë, këto takime ishin me rëndësi jetike për ndërtimin e urave midis gazetarëve investigativë, akademikëve dhe përfaqësuesve të OJQ-ve, si dhe

midis shoqërisë civile dhe qeverisë. Gjithashtu, këta dialogë përbënin një mundësi edhe për të ekspozuar punën e GI-TOC-së në rajon pas pothuaj dy vitesh pandemie "KOVID-19", për të ripërtëritur kontaktet, krijuar partneritete të reja dhe fuqizuar rrjetet kundër krimit të organizuar. Takimi i fundit i serisë do të zhvillohet në Podgoricë të Malit të Zi në mes të dhjetorit.

Gjakmarrja në Shqipëri është një praktikë që vazhdon të mbulohet nga njëfarë sekreti dhe misteri. Gjakmarrja, e cila i ka fillesat në një zakon të shekullit të 15-të, vazhdon të ekzistojë edhe sot në disa vende të Shqipërisë, sidomos në veri të vendit. Viktimat e mundshme ngujohen në shtëpitë e tyre në mënyrë të përhershme ose arratisen ose drejt pjesëve të tjera të Shqipërisë, ose jashtë vendit. Duke u mbështetur në burimet parësore, ne do të shqyrtojmë se sa e përhapur është praktika, lidhjet që ajo ka me krimin e organizuar dhe se çfarë hapash po ndërmarrin autoritetet shqiptare për ta adresuar atë.

Në fund, zhvillojmë një intervistë me përftuesin e "Fondit të Qëndrueshmërisë", Elion Pula, mjeshtër i taekuondusë, i cili u kthye nga Italia në qytetin e tij të lindjes, Shkodër, për t'u mësuar arte marziale të rinjve në komunitet. Ne bisedojmë me të lidhur me kërcënimin që përbën krimi i organizuar në Shkodër dhe se si mund ta fuqizojë sporti aftësinë e të rinjve për t'i bërë ballë krimit të organizuar dhe dhunës.

Referencat për Kosovën në këtë "Buletin të Rrezikut" janë bërë pa cenuar pozicionet lidhur me statusin e vendit dhe janë në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe me opinionin këshillimor të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me shpalljen e pavarësisë nga Kosova.

Nëse dëshironi të sugjeroni ndonjë histori ose të bëni komente, jeni të lutur të na kontaktoni në adresën e e-mailit: Kristina.Amerhauser@globalinitiative.net.

1. Lidhjet midis politikës, etnisë dhe krimit të organizuar në veri të Kosovës.

Qyteti i Mitrovicës në veri të Kosovës shpesh ka qenë vatrë e tensioneve ndëretnike midis serbëve etnik dhe shqiptarëve etnikë, ose midis popullsisë lokale dhe komunitetit ndërkombëtar. Mitrovica e Veriut dhe komunat e Leposaviçit, Zubin-Potokut dhe Zveçanit në veri të Kosovës (me popullsi që përlllogaritet të jetë 80 000 banorë),¹ konsiderohen edhe si vatra të krimit të organizuar.² Në tetor të vitit 2021, në kuadër të goditjes

së krimit të organizuar në pjesë të ndryshme të Kosovës, policia realizoi një bastisje kundër grupeve kriminale në zonën e Mitrovicës, çka rezultoi në përplasje të dhunshme. Cilat janë lidhjet midis politikës, etnisë dhe krimit të organizuar në veri të Kosovës në këtë rajon të paqëndrueshëm?




FIGURA 1 Mitrovica, në veri të Kosovës, dhe komunat fqinje janë vatra të kimit të organizuar në vend.

EKONOMI GRI NË NJË ZONË GRI

Që prej fundit të luftës së vitit 1999 në Kosovë, pjesa veriore e vendit ka qenë e ndarë sipas vijave etnike. Vija hipotetike ndarëse është lumi Ibër, i cili ndan komunitetet me shumicë serbe në veri nga komunitetet shqiptare në jug.³ Për shumë kohë, urat që lidhnin dy brigjet e lumit në Mitrovicë janë parë nga serbët si "simbole të rezistencës", ndërsa shqiptarët i kanë parë ato si "simbole të unitetit".⁴



Pamje e Mitrovicës. Qyteti është i ndarë midis serbëve etnikë dhe shqiptarëve etnikë. Fotoja: Pierre Crom/"Getty Images"

Statusi i kontestuar i rajonit dhe ekzistenca "de facto" e autoriteteve (që shpesh mbështeten nga Serbia), si dhe prania e strukturave paralele të sigurisë, ka bërë të mundur ekzistencën e një niveli të lartë vetëqeverisjeje "de facto". Kjo ka krijuar edhe një mjedis ku lejohen veprimtaritë e paligjshme për trafikantët serbë dhe shqiptarë.⁵ Ky rajon është konsideruar edhe si vend i mirë fshehjeje për të arratisurit, për shembull, nga Serbia.

Kjo situatë filloi të ndryshojë në vitin 2013 për shkak të një marrëveshjeje midis Beogradit dhe Prishtinës, e lidhur në Bruksel, me të cilën, ndër të tjera, u shpërbënë strukturat paralele të sigurisë.⁶ Kjo i ka dhënë qeverisë së Kosovës dhe strukturave të saj ekzekutive një ndikim më të madh në rajon. Pavarësisht kësaj, mosmarrëveshjet e pazgjidhura midis Prishtinës dhe Beogradit kanë çuar në tensione të fuqishme që ndonjëherë bëhen të papërmbajtshme. Më tej, mungesa e bashkëpunimit midis policisë dhe autoriteteve gjyqësore serbe dhe kosovare "i paralizon këto organe dhe i bën ato të paafta për të luftuar kriminelët".⁷

LIDHJET MIDIS KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE POLITIKËS

Veriu i Kosovës mbështetjet financiarisht nga Serbia. Më tej, në pajtim me Marrëveshjen e Brukselit të vitit 2013, katër komuna në veri kanë qasje edhe në fondet nga buxheti shtetëror i Kosovës, i rezervuar për vetëqeverisjen lokale. Krahas kësaj mbështetjeje financiare, kjo zonë merr fonde edhe nga donatorë ndërkombëtarë (sidomos nga BE-ja) dhe një fond shtesë

Gjithsesi, tensionet mbi tryezën e diskutimeve nuk e kanë ndalur tregtinë e paligjshme që zhvillohet poshtë saj. Veriu i Kosovës përdoret si zonë buferike midis Kosovës dhe Serbisë për kontrabandimin e mallrave, medikamenteve, cigareve, alkoolit dhe drogës. Me përjashtim të kanabisit, pjesa më e madhe e mallrave që futen kontrabandë në juridiksion janë produkte të ligjshme që transportohen në rrugë të vogla dytësore me qëllim shmangien e tarifave doganore dhe taksave të akcizës. Një pjesë e trafikimit kryhet nga grupe të organizuara, por pjesa më e madhe kryhet nga persona privatë që sjellin pajisje elektroshtëpiake, medikamente, artikuj ushqimorë dhe pije alkoolike nga Serbia. Shteti i dobët i së drejtës dhe energjia elektrike falas raportohet se e kanë bërë këtë rajon një vatrë tërheqëse për nxjerrjen e kriptovalutave.⁸ Situata meriton një analizë më të thellë për të hedhur më shumë dritë mbi reputacionin e rajonit si "vrimë e zezë e krimit të organizuar".

për zhvillimin. Ky i fundit përbëhet nga tarifat doganore që paguhen për mallrat e importuara për konsumim në veriun e Kosovës. Megjithatë, që prej vitit 2014,⁹ këto fonde kanë pësuar rënie të vazhdueshme, çka duket se përkon me veprimtaritë e kontrabandimit të përkrahura më sipër. Këto fonde synohen të përdoren për zhvillimin e rajonit. Megjithatë, të pakta janë të



Lumi Ibër ndan komunitetet me shumicë serbe në veri të vendit nga komunitetet shqiptare në jug.

Fotoja: Lekic Dragan/Gamma-Rapho nëpërmjet platformës "Getty Images"

dhënat lidhur me mënyrën se si shpenzohen paratë.

Duke qenë se industria në këtë rajon është fare e paktë (ajo përbëhet kryesisht nga biznese të vogla), kushdo që kontrollon burimet publike në këtë ekonomi të qira-kërkimit ("rent-seeking economy") bart pushtet të konsiderueshëm. Që të mbijetojnë, bizneset varen nga lidhjet me patronët politikë. Në fakt, për pjesën më të madhe të njerëzve në veri, është më me leverdi të përfitojnë nga qasja në fondet publike sesa të punojnë. Kjo situatë nxit korrupsionin përmes klientelizmit dhe krijon një ekonomi politike varësie.

Politika në veriun e Kosovës mbizotërohet nga një parti politike, Lista Serbe, e cila ka lidhje të ngushta me Partinë Progressive të Serbisë, e cila drejtohet nga presidenti serb Aleksandër Vuçiq.¹⁰ Zëvendëskryetari i Listës Serbe është Milan Radoiçiçi, ortak i ngushtë me Zvonko Veselinoviçin, një biznesmen serb famëkeq që ka fituar disa kontrata publike për projekte ndërtimi dhe autostrada në Serbi dhe është pronar i një hoteli të mirënjohur në Kopaonik.¹¹ Në vitin 2019, Radoiçiçi dhe Veselinoviçi u akuzuan se drejtonin një grup të krimit të organizuar që ishte përgjegjës për vrasjen e udhëheqësit politik rival serb, Oliver Ivanoviç, në janar të vitit 2018.¹² Përpara se të vdiste, në një intervistë për Rrjetin Ballkanik për Gazetari Investigative, Ivanoviçi e përshkroi Radoiçiçin si "udhëheqës i errët i veriut të Kosovës" dhe si "figurë kyçe në një sistem kërcënues pushteti në veriun e Kosovës". Më tej,

Ivanoviçi pretendonte se Radoiçiçi përfaqësonte një qendër joformale pushteti dhe vendimmarrjeje mbi rajonin.

Në nëntor të vitit 2018, policia e Kosovës u përpoq ta arrestonte Radoiçiçin në Mitrovicë, por ai u shmang dhe për dy vite nuk u ndje.¹³ Në fillim të vitit 2021, urdhri për arrestimin e tij u anulua dhe ai u kthye në Kosovë, ku u rizgjodh njëzëri zëvendësudhëheqës i Listës Serbe në korrik të vitit 2021.¹⁴

Më 8 dhjetor, SHBA-ja, në kuadër të strategjisë së saj për goditjen e korrupsionit, e përfshiu Radoiçiçin, Veselinoviçin dhe një numër qytetarësh të tjerë të Kosovës në një listë të zezë. Në një deklaratë, Departamenti Amerikan i Thesarit e përshkruante Veselinoviçin si udhëheqës të një grupi krimi të organizuar që "është përfshirë në një skemë të gjerë rryshfeti me zyrtarët kosovarë dhe serbë të sigurisë që i lehtësojnë grupit trafikimin e paligjshëm të mallrave, parave, substancave narkotike dhe armëve midis Kosovës dhe Serbisë". Në deklaratë thuhet edhe se ai "kishte komplotuar me politikanë të ndryshëm në disa marrëveshje "quid pro quo", duke përfshirë edhe mitmarrjen, në fillim të vitit 2019, të zyrtarëve kosovarë të sigurisë për të mundësuar kontrabandimin midis Serbisë dhe Kosovës dhe mitmarrjen, në fund të vitit 2017, të zyrtarëve kosovarë të sigurisë së kufijve për të mundësuar kalimin e sigurt të trafikantëve".¹⁵



Automjet i dëmtuar pas përplasjes midis policisë dhe protestuesve lokalë gjatë operacionit kundër kontrabandimit të mallrave, Mitrovicë, 13 tetor 2021. Fotoja: Reuters/Laura Hasani nëpërmjet platformës "Alamy"

GODITJA E KRIMIT

Edhe pse qeveritë e mëparshme të Prishtinës kanë bërë kujdes kur është fjala për luftimin e ekonomisë politike të veriut të Kosovës, qeveria e drejtuar nga kryeministri Albin Kurti ka premtuar se do të ndalojë krimin e organizuar dhe korrupsionin. Sipas Kurtit, që kur ai mori detyrën në mars të vitit 2021, janë kryer 437 operacione policore që kanë shkatërruar 31 grupe kriminale.¹⁶

Një operacion kryesor u krye nga Policia e Kosovës më 13 tetor 2021, kryesisht në komunat e Prishtinës, Pejës, Mitrovicës së Jugut dhe Mitrovicës së Veriut.¹⁷ Vëmendja e medias u përqendrua sidomos tek aksioni policor në Mitrovicën e Veriut. Bastisja u krye ndërkohë që tensionet midis Prishtinës dhe Beogradit ishin rritur, pas një mosmarrëveshjeje lidhur me targat dhe pak para zgjedhjeve vendore të 17 tetorit.

Kur njësitë e Policisë së Kosovës hynë në Mitrovicë, ato u bllokuan nga turmat që filluan të bërtisnin dhe hidhnin gurë drejt efektivëve të policisë.¹⁸ Tensionet u rritën edhe më shumë kur u aktivizua alarmi i emergjencave të komunës, çka bëri që në rrugë të dilnin edhe më shumë njerëz. Si kundërpërgjigje, policia u përforcua me njësi speciale policore të armatosura rëndë nga kampi "Belvedere" që ndodhet afër, në Mitrovicën e Jugut.¹⁹ Ai që duhej të ishte operacion kundër krimin të organizuar mori trajtën e një përleshjeje midis policisë dhe anëtarëve të inatosur të popullsisë lokale. Dhuna u përshkallëzua deri aty sa u sulmuan edhe njësitë e operacioneve speciale. Një komandant i nivelit të lartë dhe nëntë efektivë të tjerë policorë (tre serbë etnikë) u plagosën si pasojë e një shpërthimi dhe predhave që u gjuajtën në drejtim të mjeteve të blinduara të policisë.²⁰ U plagosën edhe një numër civilësh. Patë disa arrestime. Policia tha se u sekuestrua një numër mallrash të

kontrabanduara dhe materiale-provë me vlerë qindra mijëra euro.²¹

Edhe pse këto bastisje mbështesin agjendën e qeverisë për të qenë e ashpër ndaj krimin, ato ndihmojnë forcat lokale që të luajnë kartën e nacionalizmit. Në një diskutim të hapur midis Vuçiqit dhe përfaqësuesve të Listës Serbe, të zhvilluar më 16 tetor 2021 në kazemat e Ushtrisë së Serbisë në Raskë (afër kufirit me Kosovën), Radoiçiçi paralajmëroi se nëse bastisjet e policisë vazhdojnë, "populli do të organizohet dhe do të mbrojnë interesin e serbëve në Kosovë".²² Me pak fjalë, këto operacione ndihmojnë për ta bërë qeverinë e Kurtit të duket e fuqishme përballë krimin, por njëkohësisht përdoren nga politikanët dhe grupet kriminale në nënrajon, të cilët përfitojnë nga status quo-ja.

Situata në veri të Kosovës vazhdon të tregojë lidhjet e ngatërruara midis krimin të organizuar dhe politikës. Gjithashtu, situata shfaq karakteristikat e vatrës së krimin të organizuar: një zonë kjo ku mbivendosen qeverisja e dobët, dobësitë socio-ekonomike dhe rrugët e trafikimit. Dhe kjo vë në dukje se bashkëpunimi ndërkufitar i kriminelëve është më i mirë sesa ai i policisë ose politikanëve.



Nisma "Ballkani i Hapur" ka për qëllim heqjen e të gjitha pengesave kufitare midis Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë.
Fotoja: militaryingermany.com

2. Çfarë ndikimi mund të ketë te krimi i organizuar nisma "Ballkani i Hapur"?

Më 4 nëntor 2021, flamujt e Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë valëvitëshin në shtyllat e prozhektorëve të rrugëve të Beogradit, për t'u uruar mirëseardhjen delegacioneve të nivelit të lartë nga Tirana dhe Shkupi në takimin më të fundit të nismës "Ballkani i Hapur". Kjo ide, e cila më përpara njihej me termin "minishengen", lindi në vitin 2019 në Novi Sad të Serbisë kur presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, dhe kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, ranë dakord të krijonin një zonë ekonomike për të përmirësuar më tej marrëdhëniet politike dhe ekonomike dhe për të fuqizuar lidhjet kulturore midis tri shteteve.²³

KRIMINELË PA KUFIJ

Qëllimi kryesor i nismës "Ballkani i Hapur" është heqja e të gjitha pengesave kufitare midis tri vendeve brenda vitit 2023. Një gjë e tillë do të eliminonte pritjet e gjata dhe të lodhshme për udhëtarët dhe përgatitjen e ndërlikuar të dokumenteve për kompanitë. Pikat e kalimit kufitar do të vazhdojnë të jenë aty, por në pikat kufitare do të krijohen korsi lëvizjeje të shpejtë për qytetarët dhe mallrat që vijnë nga vendet pjesëmarrëse dhe në këto pika nuk do të kryhen kontrolle. Krahas kësaj, udhëheqësit nënshkruan tri dokumente për lehtësimin e importit, eksportit dhe lëvizjes së mallrave, qasjen në tregun e punës dhe bashkëpunimin për mbrojtje në raste fatkeqësie natyrore.²⁵ Për pasojë, mallrat dhe njerëzit do të lëvizin më shpejt, do të krijohet një treg i përbashkët me 12 milionë njerëz dhe bashkëpunimi tregalësh do të përmirësohet.²⁶

Emri i ri i kësaj nisme u përdor për herë të parë në qershor të vitit 2021, në një takim të Forumit Ekonomik për Bashkëpunim Rajonal në Shkup. Ndonëse është e qartë që kjo nismë ka meritat e veta, a do të lehtësoheshin prurjet e paligjshme nëse do të hapeshin më tej kufijtë dhe tregjet? Disa e shohin këtë nismë si shkallare drejt anëtarësimit në BE. Të tjerët e shohin si shpërqendrim ose kopjim të marrëveshjeve ekzistuese siç është Tregu i Përbashkët Rajonal. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, për shembull, ka qenë tepër kritik ndaj kësaj nisme.²⁴ Mali i Zi i ka monitoruar zhvillimet, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina duket skeptike dhe e angazhuar me problemet e saj të brendshme.

Me përjashtim të "Marrëveshjes për bashkëpunim në mbrojtjen nga fatkeqësitë", nisma "Ballkani i Hapur" është pothuajse identike me Tregun e Përbashkët Rajonal të mbështetur nga BE-ja. Megjithatë, duket se nisma "Ballkani i Hapur" është pjesërisht e motivuar nga përparimi i ngadaltë i anëtarësimit në BE dhe, në rastin e Shqipërisë dhe Serbisë, nga pakënaqësitë me obstrukcionizmin e perceptuar të Prishtinës. Rreziku është që ekzistojnë dy procese paralele konkurruese, çka do të thellojnë ndasitë në rajon në vend që të përmirësojnë bashkëpunimin. Kthimi i kësaj nisme në realitet do të kërkojë bashkëpunim institucional, harmonizim ligjor dhe ndërveprueshmëri (sidomos për shkëmbimin e informacionit). Gjithashtu, do të duhen edhe burime. Por a do t'ua bëjë heqja e kufijve më të lehtë kriminelëve të veprojnë përtej kufijve?

Me apo pa nismën "Ballkani i Hapur", kriminelët në Ballkanin Perëndimor kanë kohë që lëvizin dhe bashkëpunojnë përtej kufijve, ku zonat kufitare priren të jenë vatra të krimit të organizuar. A do të çonte hapja e kufijve në uljen e motivimit të trafikantëve për t'u mbledhur rreth zonave kufitare? (Për shembull, midis Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë për trafikimin e drogës dhe emigrantëve, ose midis Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut sidomos për kontrabandimin e kanabisit.) Ulja e kontrolleve kufitare mund të ulë korrupsionin në radhët e rojeve kufitare, por kjo do të ulte edhe aftësinë e tyre për të zbuluar drogën dhe mallrat e tjera të kontrabanduara gjatë kontrolleve rutinë. Gjithashtu, duke qenë se prurjet e ligjshme dhe të paligjshme kalojnë nëpër të njëjtat rrugë dhe përdorin infrastrukturë të ngjashme, hapja e kufijve pa bashkëpunim më të mirë në fushën e sigurisë do të krijonte më shumë mundësi për krimin e organizuar ndërkombëtar.

Nëse Kosova do të bëhej pjesë e kësaj nisme (gjë që, tani për tani, nuk duket se ka të ngjarë të ndodhë), do të hapeshin mundësitë për uljen e tensioneve që kanë të bëjnë me kufirin dhe problemet kufitare. Gjithashtu, një gjë e tillë do të lehtësonte prurjet e paligjshme, duke qenë se Kosova kufizohet me katër nga pesë juridiksionet e tjera dhe ka rrugë të shkëlqyera. Nga ana tjetër, nëse Kosova nuk bëhet pjesë e kësaj nisme,

ajo do të bëhej portal më pak tërheqës për trafikimin nga Shqipëria ose Maqedonia e Veriut, duke qenë se trafikantët mund ta anashkalojnë duke ndjekur një rrugë relativisht të parrezikshme për ta.

Nëse kufijtë midis shteteve nënshkruese të nismës hapen më shumë, pikat e hyrjes në ato tregje mund të bëhen objekt i mosmarrëveshjeve më të mëdha. Për shembull, pas kalimit nga një port i Shqipërisë, kontrolli kufitar i radhës për qytetarët e Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut ose Serbisë mund të jetë në pikën e kalimit kufitar midis Serbisë dhe Hungarisë. Armët ose cigaret që kontrabandohen nga Serbia ose Maqedonia e Veriut mund të mbërrijnë në Adriatik pa asnjë kontroll kufitar. Kjo mund të rrisë konkurrencën midis grupeve kriminale, jashtë zonës dhe jo midis shteteve që janë brenda zonës, për qasje te portet ose pikat kryesore të kalimit kufitar tokësor. (Për shembull, nëse grupet shqiptare dhe serbe që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Amerikën Latine do të bashkëpunonin për ta kaluar kokainën përmes porteve të Shqipërisë dhe për ta shpërndarë më pas në Evropën Perëndimore nëpërmjet vendeve të nismës "Ballkani i Hapur".) Kjo ose do ta përmirësonte bashkëpunimin midis grupeve kriminale në Ballkan, sikurse ndodh tashmë në Amerikën Latine, ose ka të ngjarë të ndezë një luftë midis tyre, për shembull, lidhur me kontrollin mbi trafikimin e kokainës përmes porteve të Shqipërisë.

RITJIA E BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN E ZBATIMIT TË LIGJIT

Njëllloj siç çoi heqja e kufijve brenda BE-së në rritje të bashkëpunimit midis agjencive të zbatimit të ligjit, sidomos nëpërmjet Europolit, Fronteksit dhe Kodit për Kufijtë e Shengenit,²⁷ diskutimet lidhur me hapjen e mëtejshme të kufijve ose me një treg të përbashkët rajonal duhet të shihen si mundësi që duhet shfrytëzuar për të krijuar një sistem të integruar për kontrollin e kufijve, për të përmirësuar operacionet e përbashkëta të policisë, të drejtuara nga inteligjenca, dhe për t'i ofruar njëri-tjetrit ndihmë juridike reciproke në lidhje me hetimet, ndjekjen penale, procedurat gjyqësore dhe rikuperimin e aseteve.

Këtë proces mund ta lehtësonin institucionet që ekzistojnë tashmë, siç është Qendra për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore (SELEC—Southeast European Law Enforcement Center) dhe Konventa e Bashkëpunimit Policor në Evropën Juglindore. Mund të paraqitet nevoja edhe për krijimin e një databaze të përbashkët rajonale të inteligjencës, për të gjurmuar kriminelët e kërkuar dhe luftëtarët e huaj terroristë dhe për të shkëmbyer informata në drejtim të ndihimit të hetimeve. Me uljen e numrit të kontrolleve kufitare, zyrtarët

e zbatimit të ligjit dhe zyrtarët kufitarë mund të

dërgohen përsëri në terren për të formuar ekipe lëvizëse. Ajo që duhet shmangur, të paktën në fillim, është krijimi i një tjetër organi rajonal ligjzbatues. Ekzistojnë prej kohësh organe si SELEC-i, Shoqata e Shefave të Policisë të Evropës Juglindore, Konventa e Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore (dhe sekretariati i saj) dhe Iniciativa Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë, si dhe Procesi i Berlinit.

Megjithatë, diskutimi i integritet të mëtejshëm ekonomik pa marrë parasysh pasojat për sigurinë nënkupton mungesë largpamësie. Do të ishte logjike të përdorej një organ ekzistues, siç është procesi i Qeverisjes Integruese të Sigurisë së Brendshme, i cili ka një shtyllë për luftën kundër krimit të rëndë të organizuar në Ballkanin Perëndimor, për të koordinuar politikat dhe për të bashkuar përpjekjet e të gjithë aktorëve përkatës të sigurisë. Nëse vendet e nismës "Ballkani i Hapur" dëshirojnë të bëjnë përpara më shpejt, bashkëpunimi i tyre duhet të jetë pjesë e një strategjie më të gjerë rajonale. Edhe pse hapja e mëtejshme e kufijve mund të shfrytëzohet nga grupet kriminale, nisma "Ballkani i Hapur" dhe përpjekjet e tjera për të nxitur një integrim rajonal më të madh, duhet të shihen si mundësi për të fuqizuar bashkëpunimin rajonal në fushën e zbatimit të ligjit, për të luftuar kundër krimit të organizuar.



Zakoni i gjakmarrjes vazhdon të ekzistojë në disa pjesë të veriut të Shqipërisë si në Shkodër, e cila paraqitet më sipër. Fotoja: Marka/Universal Images Group nëpërmjet platformës "Getty Images"

3. Grupet kriminale në Shqipëri shfrytëzojnë gjakmarrjen.

Shoqëria shqiptare ndonjëherë portretizohet si e dhunshme për shkak të normave të saj të vrazhda kulturore, siç është gjakmarrja. Ky zakon i ka fillesat në shekullin e 15-të dhe njihet me termin "Kanuni i Lekë Dukagjinit".²⁸ Sikurse ndodh në komunitetet e tjera malore të largëta (si në Mal të Zi, Kosovë dhe në disa pjesë të Kaukazit), kjo praktikë u zhvillua si mënyrë për të mbrojtur familjet në mungesë të një shteti të fuqishëm qendror.²⁹ Frika nga ndërsjellja u projektua për të qenë element që dekurajonte aktet e dhunës: personi që i merrte jetën dikujt rrezikonte të krijonte një spirale

INSTRUMENTALIZIMI I GJAKMARRJES

Sot, ideja e gjakmarrjes është pjesë e faktorit të frikës të grupeve kriminale shqiptare. Ajo ndihmon që grupet të duken si ushtrues të mundshëm dhune, që u bien pas kundërshtarëve dhe marrin hak.³³ Gjithashtu, gjakmarrja i vesh sjelljet e grupeve kriminale me petkun e normave zakonore ose tradicionale.³⁴ Pavarësisht kësaj, grupet kriminale nuk priren të rekrutojnë njerëz që kanë lidhje me familjet e përfshira në gjakmarrje, sepse nuk duan të bëhen pjesë e këtyre konflikteve të stërzgjatura.³⁵ Gjithashtu, ato bëjnë kujdes kur luftojnë kundër familjeve të fuqishme në zonat e veriut të Shqipërisë, për shkak se rrezikojnë të krijojnë gjakmarrjen: kjo do t'u prishte punë.³⁶

Megjithatë, kërkimet shkencore të fundit kanë treguar se ndonjëherë grupet kriminale zbatojnë variantin e tyre të gjakmarrjes.³⁷ Sipas "Kanunit", nuk lejohet të marrësh hak për një pjesëtar familjeje që është vranë ndërkohë që ka qenë

hakmarrjeje "me të njëjtën monedhë".³⁰

Ndryshe nga nocioni "sy për sy", gjakmarrja nuk ndalet patjetër pas kryerjes së një akti shpagimi, por mund të vazhdojë për breza të tërë derisa të mos ketë më anëtarë meshkuj në asnjërën palë.³¹ Qëllimi i këtij zakoni ishte të parandalonte kaosin, dhe jo ta shkaktonte atë. Ai ishte, në mënyrë efektive, variant i hershëm i një pakti për shkatërrim të sigurt reciprok, i cili lidhen ngushtë me vlerën e nderit dhe të familjes.³²

duke kryer një vepër të pamoralshme (p.sh. duke vjedhur). Gjithsesi, krimi i organizuar ndonjëherë e keqpërdor "Kanunin" për të kërkuar hakmarrje: ka raste kur një grup i krimit të organizuar nuk ka mundësi të gjejë ndonjë kundërshtar dhe, në vend të tij, vret një prej pjesëtarëve të familjes së personit, duke e përligjur këtë si gjakmarrje. Në këtë situatë, pjesëtarët e familjes së viktimës shpesh fshihen ose emigrojnë nga frika e hakmarrjes së mëtejshme nga grupi i krimit të organizuar.³⁸

Për shembull, në luftën territoriale midis dy grupeve të fuqishme të krimit të organizuar në qytetin e Shkodrës,³⁹ drejtuesit e grupit kriminal "A" vrasin një anëtar kyç të grupit kriminal "B". Për t'u hakmarrë, drejtuesit e grupit kriminal "B", kur nuk janë në gjendje të gjejnë anëtarët e grupit kriminal "A", vrasin babanë ose xhaxhanë e njërit prej anëtarëve kryesorë të atij grupi. Tani, ai person e konsideron vrasjen e

CILI ËSHTË DALLIMI MIDIS GJAKMARRJES DHE HAKMARRJES?

Në gjuhën shqipe, fjala "gjakmarrje" do të thotë "të marrësh gjakun" ose "armiçësi gjaku". Hakmarrja, nga ana tjetër, është detyrimi për të "marrë jetën me qëllim vënien e drejtësisë pas një padrejtësie që ka ndodhur më herët; për të ruajtur nderin".

Këta terma përdoren këmblyshëm dhe ndonjëherë mund të jenë hutues, sepse në të dy rastet, vrasja kryhet për të vendosur drejtësinë dhe nderin. Megjithatë, dallimi kryesor qëndron në atë që gjakmarrja është varg i zgjatuar i vrasjeve hakmarrëse midis familjeve, i cili mund të zgjasë me breza të tërë, ndërsa hakmarrja është shpëtim për një vrasje, d.m.th. vrasje e tipit "sy për sy dhe dhëmbë për dhëmbë". Dallimet bëhen të paqarta në raste kur hakmarrja që bëhet për hir të një anëtarë familjeje shkakton gjakmarrje.

anëtarëve të familjes së tij si gjakmarrje, prandaj edhe do të përpiqet të vrasë anëtarët e familjes së drejtuesve të grupit kriminal "B". Me pak fjalë, edhe nëse grupet kriminale mund t'i japin fund konfliktit mes tyre, cikli i dhunës do të vazhdojë. Për pasojë, ajo që filloi si vrasje për hakmarrje lidhur me një vepër kriminale (e cila mund të jetë përkufizuar gabimisht si gjakmarrje) tashmë bëhet gjakmarrje e vërtetë.⁴⁰

Vija ndarëse midis vrasjeve dhe gjakmarrjes bëhet e paqartë edhe në lidhje me trafikimin e drogës. Kjo ndodh atëherë kur mosmarrëveshjet që kanë ndodhur jashtë vendit zgjidhen në Shqipëri ose kur rastet e gjakmarrjes, që kanë nisur në Shqipëri, eksportohen jashtë vendit. Për shembull, të afërmit e pjesëtarëve të organizatave kriminale janë duke kërkuar azil në vendet e BE-së për t'i ikur kërcënimit të hakmarrjes. Sipas një raporti të vitit 2017 nga projekti "Operazione Colomba", këto janë kërcënime të besueshme. Midis viteve 2013 dhe

2017, projekti raportonte se vrasjet me motiv gjakmarrjen ishin kryer në këto shtete: 11 në Itali, katër në Greqi dhe nga dy në Belgjikë, Francë, Gjermani dhe Holandë, dhe nga një në Kosovë, Mal të Zi, Mbretëri të Bashkuar, Republikën Çeke, Suedi, Zvicër, Kanada dhe SHBA.⁴¹ Megjithatë, duhet vënë në dukje se grupet kriminale në përgjithësi parapëlqejnë të mos ekspozohen jashtë vendit, prandaj e vazhdojnë hakmarrjen ose gjakmarrjen në Shqipëri.

Por vijat ndarëse janë të turbullta. A është çdo vrasje hakmarrjeje midis grupeve kriminale "gjakmarrje" sipas traditës së "Kanunit", apo është thjesht një spirale "normale" e dhunës midis grupeve të mafias? A kanë lidhje me krimin e organizuar të gjitha vrasje që, në plan të parë, duken se kanë të bëjnë me gjakmarrje, apo mos ndoshta disa reflektojnë larjen e hesapeve midis familjeve?

SHTRIRJA E PROBLEMIT

Midis viteve 1991 dhe 2008, të paktën 9 500 persona u vranë si pasojë e gjakmarrjes. Gjatë së njëjtës periudhë, virtualisht rreth 1000 fëmijë u ngujuan në shtëpitë e tyre për t'u mbrojtur nga gjakmarrja e vazhdueshme.⁴² Megjithatë, duket se kjo praktikë është duke u zbehur. Sipas një raporti të vitit 2018, problemi është i përqendruar kryesisht në rrethin e Shkodrës në veri të Shqipërisë.⁴³ Të dhënat tregojnë se në nivel kombëtar, 704 familje janë të përfshira në gjakmarrje, nga të cilat 113 kanë shkuar jashtë shtetit. Numri i lartë i familjeve në zonat ku gjakmarrja nuk është pjesë përbërëse e kulturës (d.m.th. në Tiranë dhe Durrës) mund të shpjegohet me faktin se familjet kanë ardhur në këto zona nga veriu i vendit, duke sjellë me vete edhe gjakmarrjen.

reputacionin e gjakmarrjes për përfitimet e tyre vetjake. Përmendja e frikës nga hakmarrja për shkak të gjakmarrjes është përdorur prej shumë kohësh si arsye për të kërkuar azil. Në disa raste, familjet kanë siguruar madje edhe vërtetime të rreme për të mbështetur pretendimet e tyre.⁴⁴ Situata ndryshoi pas arrestimit të disa individëve. Ligji u ndryshua në vitin 2014 për t'u lejuar vetëm prokurorive kompetencën për të lëshuar këto vërtetime. Më tej, një numër vendesh pritëse (Franca, Belgjika dhe Suedia, ndër të tjera) tani u kërkojnë autoriteteve shqiptare të verifikojnë vërtetimet. Në rast se vërtetimet janë të falsifikuara ose nuk mbështeten në fakte, personat përgjegjës do të ndiqen penalisht nga autoritetet shqiptare.

Kriminelët nuk janë të vetmit që abuzojnë me

Krahas kësaj, midis viteve 2012 dhe 2016, qeveria

	Tiranë	Durrës	Lezhë	Dibër	Kukës	Shkodër	Gjithsej
Familjet në gjakmarrje	68	86	105	89	87	156	591
Të ngjuara	5	6	6	-	3	17	37
Familje jashtë vendit	8	6	33	3	16	47	113

FIGURA 2 Numri i familjeve të prekura nga gjakmarrja në nivel kombëtar, 2018.

BURIMI: OJQ që punon me familjet e prekura në Shkodër.

ndërmori hapa për të kriminalizuar dhe parashikuar ndëshkime të rënda për veprat e ndërlidhura me gjakmarrjen. Për shembull, sipas nenit 78/a të Kodit Penal, vepra penale e "vrasjes për gjakmarrje" dënohet me të paktën 30 vjet heqje lirie.⁴⁵ Në nenin 83/a specifikohet se: "kanosja serioze për hakmarrje ose gjakmarrje, që i bëhet një personi për t'u mbyllur në shtëpi, dënohet me burgim deri në tre vjet." Krahas kësaj, sipas nenit 83/b "Nxitja për gjakmarrje", "nxitja e të tjerëve për hakmarrje ose gjakmarrje, kur nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në tre vjet." Të gjitha këto ndryshime ligjore në Kodin Penal hynë në fuqi në vitin 2013.

Qeveria përgatiti edhe një plan veprimi për parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe goditjen e veprimtarive kriminale kundër veprave kriminale të vrasjes për motive gjakmarrjeje dhe hakmarrjeje.⁴⁶ Në vitin 2017, policia e shtetit u ngarkua me detyrën e përgatitjes së një strategjie për zbatimin e këtij plani veprimi.⁴⁷ Disa prej pikave të planit parashikonin që policia e shtetit të mblidhte prova për familjet e përfshira në gjakmarrje, të monitoronte familjet e prekura dhe të përditësonte bazën e të dhënave me rastet aktuale. Më tej, të gjithë fëmijëve të cenuar nga gjakmarrja u është ofruar arsim në shtëpi. Gjithashtu, në vitin 2015, Parlamenti miratoi një rezolutë për të parandaluar fenomenin e gjakmarrjes në Shqipëri.⁴⁸ Pavarësisht kësaj, Avokati i Popullit raportoi më vonë gjatë atij viti që pas zgjidhjes, "konstatojmë se nuk është bërë ndonjë zgjidhje konkrete nga institucionet shtetërore për zbatimin e detyrave të caktuara nga Kuvendi për parandalimin e këtij fenomeni dhe për nxjerrjen e akteve nënligjore".⁴⁹ Në progres-raportin e vitit 2018, BE-ja vinte në dukje se "ekziston ende nevoja për përcjelljen e zgjidhjes dhe rekomandimeve lidhur me gjakmarrjen".⁵⁰

Ndërkohë, midis viteve 2017 dhe 2020, ka pasur një rritje të numrit të rasteve të regjistruara të vrasjeve për gjakmarrje. Nga pesë raste të regjistruara në vitin 2017, numri arriti në shtatë në vitin 2020. Megjithatë, përqindja e dënimeve për personat e akuzuar për këtë krim ka rënë. Vetëm njëri nga pesë rastet e regjistruara për hetim në vitin 2017 u shpall fajtor me vendim gjykatë. Nga shtatë rastet e regjistruara në vitin 2020, vetëm njëri u çua në gjykatë: i pandehuri u shpall i pafajshëm. Në të njëjtën mënyrë, në vitin 2020, vetëm njëri nga katër rastet e regjistruara për "nxitje të gjakmarrjes" u çua në gjykatë.⁵¹ Midis periudhës 2017-2020, numri më i lartë i rasteve të nxitjes, të regjistruara brenda një viti, ishte 11 (në vitin 2018). Vetëm një prej tyre u çua në gjykatë, e cila u shpall i pandehur fajtor.⁵²

Dukuria e gjakmarrjes vazhdon të ekzistojë në Shqipëri, pavarësisht se është e kufizuar kryesisht në veri të vendit. Praktika e saj vazhdon të mbulohet nga njëfarë sekreti dhe misteri. Duhet bërë studime më të hollësisht për të përfutur një panoramë të qartë të situatës dhe për të mundësuar përllogaritjen e shkallës dhe të efektit të përhapjes ("spillover effect") tek anëtarët e familjes së viktimave, si në Shqipëri, ashtu edhe jashtë vendit.

Ajo që është e qartë është se politikat aktuale shtetërore nuk mjaftojnë për ta çrrënjësuar këtë dukuri. Ndonëse viktimave u ofrohet mbrojtje, besimi në sistemin e drejtësisë është i ulët. Kjo pengon bashkëpunimin e nevojshëm midis komunitetit dhe agjencive shtetërore përkatëse. Nëse gjakmarrja u zhvillua në mjedise ku shteti ligjor ishte i dobët, ekzistenca e një sistemi më efikas të drejtësisë penale do të ulte vlefshmërinë e këtij preteksti për dhunë.

4. Nismat lokale: Dialogët për qëndrueshmërinë në Ballkanin Perëndimor.

Në tetor dhe nëntor të vitit 2021, SEE-Obs-ja vazhdoi një seri dialogësh për qëndrueshmërinë duke zhvilluar takime në Tiranë, Beograd, Sarajevë dhe Prishtinë. Këto takime i mundësuan GI-TOC-së dhe partnerëve të saj nga shoqëria civile që të merrnin pjesë përsëri fizikisht pas pothuaj dy vitesh pandemie "COVID-19", për të fuqizuar bashkëpunimin midis OJQ-ve, gazetarëve investigativë dhe

akademikëve që punojnë në fushën e krimit të organizuar dhe për të ndërtuar ura midis aktorëve të shoqërisë civile dhe qeverisë në lidhje me luftën e përbashkët kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. GI-TOC-ja zhvilloi diskutime, në secilin kryeqytet, edhe me përfaqësues të komunitetit diplomatik dhe shoqërisë civile dhe me zyrtarë publikë për të prezantuar aktivitetet e saj më të fundit.

LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT NË SHQIPËRI

Më 28 dhe 29 tetor, në dialogun për qëndrueshmërinë, të zhvilluar në Tiranë të Shqipërisë, u mblodhën përfaqësuesit e shoqërisë civile nga i gjithë vendi. Në fokus të takimit ishin sfidat me të cilat përballet rinia në Shqipëri dhe gjërat që janë duke bërë OSHC-të për të pakësuar dobësitë e

rinisë përballë krimit të organizuar. Ndër temat kryesore që u ngritën ishin nevoja për rol-modele pozitive, alternativa ndaj narrativës së "pasurimit të shpejtë", mundësitë dhe rreziqet e emigrimit, nevoja për mbështetjen e bizneseve të vogla në fazat e tyre të hershme dhe ndikimi i kanabisit në



Diskutim në tryezë të rumbullakët gjatë dialogut për qëndrueshmërinë në Sarajevë të Bosnjës dhe Hercegovinës. Fotoja: Bahrudin Bandic

disa komunitete (kryesisht rurale) si dhe rinia. Pjesëmarrësit shkëmbyen edhe përvojat e tyre lidhur me ripërdorimin social të aseteve të konfiskuara nga grupet kriminale. Përfaqësuesit e OSHC-ve, kryesisht gra nga komunitetet jashtë kryeqytetit, diskutuan nevojën për kurajën civile dhe sfidat e ndërveprimit me qeverinë lokale, si dhe vështirësitë në shndërrimin e projekteve të financuara afatshkurta në nisma të qëndrueshme afatgjata.

Në këtë takim u diskutua edhe lidhur me mënyrën se si duhen ndërtuar urat midis OSHC-ve dhe qeverisë në funksion të parandalimit dhe luftës ndaj korrupsionit. Fjala hapëse e Adea Pirdenit, zëvendësministre e Drejtësisë, dhe Jorida Tabakut, kryetare e Këshillit Kombëtar të Integritetit dhe e Komitetit Parlamentar për Integritimin Evropian, u pasuan nga një diskutim lidhur me mënyrën e fuqizimit të kulturës së integritetit në institucionet publike dhe sektorin privat; mënyrën e rritjes së vetëdijesimit të publikut për ndikimin e korrupsionit; nevojën për përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e hartimit dhe zbatimit të ligjeve dhe strategjive kundër korrupsionit; dhe mënyrën e ruajtjes së funksionit të "ruajtësit" të OSHC-ve antikorrupsion, ndërkohë që qeveria vazhdon t'i shohë ato si partnerë konstruktivë.

Ndër problematikat e ngritura ishin korrupsioni në media dhe nevoja për mbrojtje më efektive për informatorët dhe për një organ antikorrupsion më të pavarur. Zëvendës ministrja dhe përfaqësuesit e OSCH-ve falënderuan GI-TOC-në për organizimin e takimit të cilin ata e panë si hap të rrallë e të nevojshëm në funksion të përmirësimit të dialogut dhe mirëbesimit midis shoqërisë civile dhe qeverisë në drejtim të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit.

Në një takim me audiencë më të gjerë, SEE-Obs-ja ftoi gazetarë shqiptarë për të bashkëndarë përvojat e tyre në fushën e hetimit të veprimtarive të grupeve shqiptare të krimit të organizuar që kryejnë aktivitete në Shqipëri dhe jashtë vendit. Informacionet për rrugët e trafikimit të kokainës nga Amerika Latine drejt Evropës ishin veçanërisht zbuluese. Ndër çështjet e ngritura në diskutimin e radhës ishin: vështirësitë në qasjen në informacion, mbrojtja që zyrtarët publikë u japin kriminelëve, mungesa e ndjekjes penale të rasteve të nivelit të lartë për krimin e rëndë të organizuar, cenueshmëria e të rinjve të ndikueshëm përballë krimit të organizuar (ku përfshihet ngritja në qiell e krimit dhe rol-modeleve devijuese në rrjetet sociale) dhe mungesa e raportimit të thellë investigativ në terren në krahasim me diskutimet sipërfaqësore rreth krimit të organizuar në studiot televizive.

OSHC-TË SI OFRUESE SHËRBIMESH NË SERBI

Edhe në dialogun për qëndrueshmërinë, të zhvilluar në Beograd të Serbisë në datat 4 dhe 5 nëntor, u mblodhën përfaqësues të OSHC-ve nga i gjithë vendi. Ky takim pati në fokus rolin që kanë OSHC-të në përkrahjen ndaj përdoruesve të drogës, reformën pas-penale dhe të rinjtë e të rejtat që janë të cenueshme ndaj krimit të organizuar. Çështje të tjera ishin edhe kreditë grabitqare me interesa shumë të larta ("loan-sharking"), huliganizmi në futboll, prurjet financiare të paligjshme, trafikimi i qenieve njerëzore dhe ndikimi i korrupsionit dhe grupeve kriminale në qeverinë lokale dhe qendrore.

Një numër pjesëmarrësish vuri në dukje vështirësitë me të cilat përballen OSHC-të në Serbi, duke përfshirë mungesën e qasjes në informacion, burimet e kufizuara, mungesën e komunikimit me zyrtarët e qeverisë vendore, hutinë që shkaktojnë OJQ-të që organizohen nga qeveria, ngurrimin e donatorëve dhe shoqërisë civile për të trajtuar problematikat e krimit të organizuar, dhe madje edhe kërcënimin dhe përdorimin e ligjit kundër OSHC-ve.

PËRQENDRIMI TEK EMIGRACIONI NË BOSNJË DHE HERCEGOVINË

Në dialogun për qëndrueshmërinë, të mbajtur në Sarajevë të Bosnjës dhe Hercegovinës, në datat 15 dhe 16 nëntor, morën pjesë përfaqësues të OSHC-ve nga Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Republikës Serbe dhe nga Rrethi i Bërçkos. Morë pjesë edhe OJQ-të që përfaqësonin policinë. Njëlloj si në kryeqytetet e tjera, përfaqësuesit e shoqërisë civile u treguan kritikë ndaj mungesës së qasjes në informacion, burimeve të kufizuara dhe mundësive të kufizuara për angazhim me zyrtarët publikë. Gjithashtu, ata vunë në dukje se bashkëpunimi kundër krimit të organizuar pengohet nga situata politike e polarizuar në vend dhe nga sistemi shumë-nivëlësh i qeverisjes.

Ndër problematikat e ngritura ishte edhe nevoja për pjesëmarrje më aktive nga rinia në çështjet që kanë të bëjnë me rritjen e vetëdijesimit për dëmet e krimit të organizuar dhe korrupsionit, rritjen e mbështetjes për gazetarinë investigative, dhe shtimin e mundësive për komunikim midis OSHC-ve dhe institucioneve publike, për shembull lidhur me informimin dhe mbështetjen ndaj përdoruesve të drogës dhe ndaj emigrantëve.

U zhvillua një diskutim rreth temës së ndërtimit të urave midis qeverisë dhe shoqërisë civile në funksion të trajtimit më efikas të sfidës së migrimit në Bosnjë dhe Hercegovinë. Përfaqësuesit e shoqërisë civile nga një prej rajoneve më të prekura, kantoni i Una-Sanës, i cili ndodhet pranë kufirit me Kroacinë, përshkruan me hollësi situatën e

Pavarësisht kësaj, në një seancë ku morën pjesë një numër i kufizuar zyrtarësh publikë, u vu re se midis OSHC-ve dhe qeverisë kishte bashkëpunim të mirë lidhur me problematikat e trajtimit të drogës dhe reformën pas-penale. Zyrtarët publikë pranuan vlerën e shtuar të OSHC-ve si ofruese shërbimi në komunitetet ku ato janë aktive. Megjithatë, OSHC-të që merren me problematikat që kanë të bëjnë me krimin e organizuar ose vënien në dukje të korrupsionit pranoheshin më pak.

Në seancën publike, përfaqësuesit e SEE-Obs-së nënvizuan nevojën për nxitjen e më shumë debateve dhe analizave rreth problematikave që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe korrupsionin si dhe për pasjen e një angazhimi më konstruktiv midis qeverisë dhe shoqërisë civile. U vu në dukje se OSHC-të mund të jenë "faktor i rëndësishëm korrigjues" i politikave qeveritare dhe se ato mund të propozojnë zgjidhje për përmirësimin e situatës.

rëndë humanitare me të cilën përballen personat që lëvizin nga njëri vend në tjetrin. Zyrtarët publikë, duke përfshirë pjesëtarët e policisë kufitare, përshkruan sfidat me të cilat përballen kur merren me problemin, duke përfshirë bashkëpunimin e pamjaftueshëm me disa vende fqinje dhe komunitetin ndërkombëtar dhe burimet e pamjaftueshme dhe korrupsionin në pikat e kalimit kufitar. Pavarësisht kësaj, u vu në dukje se në vitin 2021, numri i emigrantëve të përzier në Bosnjë dhe Hercegovinë pësoi rënie. Pjesëmarrësit diskutuan edhe për trafikimin e qenieve njerëzore në vend, duke përfshirë cenueshmërinë e emigrantëve ndaj shfrytëzimit për qëllime seksi ose në punë të detyruar.

Pjesëmarrësit vlerësuan mundësinë për t'u takuar dhe shkëmbyer pikëpamje në mënyrë konstruktive dhe diskutuan rreth ideve për bashkëpunime të mundshme në të ardhmen. Ndonëse theksuan rëndësinë që ka ruajtja e pavarësisë së shoqërisë civile, ata ranë dakord se kur është fjala për problematika si droga, migracioni dhe korrupsioni, organizatat e shoqërisë civile dhe zyrtarët publikë "kanë të njëjtin qëllim".

Ndërkohë që ishte në Sarajevë, personeli i GI-TOC-së u takua me ministrin e Sigurisë, drejtorin e departamentit politik të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal dhe këshilltaren e lartë kundër korrupsionit në Nismën Rajonale Kundër Korrupsionit.

FUQIZIMI I KOALICIONEVE KUNDËR KRIMIT NË KOSOVË

Dialogu i pestë për qëndrueshmërinë u zhvillua në Prishtinë të Kosovës në datat 25 dhe 26 nëntor. Fokusi kryesor i takimit ishte mënyra e krijimit të koalicioneve dhe zhvillimit të narrativave në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në takim u mbledhën grupe të ndryshme pjesëmarrësish nga i gjithë vendi: gazetarë investigativë, ekspertë nga institutet kërkimore dhe aktivistë nga organizatat-bazë. Pjesëmarrësit theksuan se media duhet t'i kushtojë më shumë vëmendje krimit të organizuar në Kosovë, përtej mbulimit të problematikave të tilla si rryshfeti dhe mungesës së transparencës në proceset e prokurimit publik. Gazetarët u inkurajuan të mbulonin grupet e krimit të organizuar, të cilat veprojnë në Kosovë, dhe tregjet kriminale si p.sh. trafikimi i drogës dhe mallrave të falsifikuar dhe krimi mjedisor. Një numër pjesëmarrësish ra dakord se Kosova duhet të hartojë ligjërimin e saj vetjak lidhur me krimin e organizuar, në vend që thjesht ta shohë këtë problem në vendet fqinje si Shqipëria ose Serbia. Gjithashtu, ata theksuan se duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje grupeve të organizuara kriminale kosovare që veprojnë jashtë vendit.

TË PUNOSH PËR NJË BALLKAN TË QËNDRUESHËM

Këta dialogë kanë zbuluar sfidat me të cilat përballen OSHC-të që merren me problematikën e krimit të organizuar dhe korrupsionit, shumë prej të cilave janë përkeqësuar nga pandemia "KOVID-19". Por në këta dialogë u theksua edhe puna e guximshme dhe e përkushtuar që bëjnë OSHC-të në komunitetet e tyre. Takimet përforcuan nevojën për ndërtimin e urave midis shoqërisë civile dhe qeverisë dhe për bashkëpunimin drejt një qëllimi të përbashkët. Pjesëmarrësit diskutuan aktivitete të mundshme përcjellëse pas dialogëve

Pjesëmarrësit diskutuan lidhur me mënyrat e fuqizimit të marrëdhënies midis medias dhe OJQ-ve. Për shembull, u vu në dukje që, nëse gazetarët përqendrohen më shumë të krimi i organizuar dhe korrupsionit, OJQ-të do të ishte mirë të promovonin punën e tyre dhe të rrisnin presionin mbi qeverinë për ta detyruar këtë të fundit të marrë masa duke marrë për bazë gjetjet e raportimit investigativ.

Në një takim me zyrtarët e sektorit publik, përfaqësuesit e OSHC-ve patën mundësinë e rrallë të ndërvepronin me zëvendësministren e Drejtësisë, një anëtar të policisë kundër krimit të organizuar dhe një përfaqësues të agjencisë kombëtare antikorruption, dhe me një sinjalizues. Pjesëmarrësit diskutuan sfidat e tyre në trajtimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe morën pjesë në një dialog konstruktiv për përmirësimin e llogaridhënies dhe transparencës në sektorin publik dhe për të nxitur një bashkëpunim më të madh midis sektorit publik dhe shoqërisë në përgjithësi.

Tri tema-lajtmotiv të dialogëve për qëndrueshmërinë ishin: rinia, gjinia dhe ripërdorimi social i aseteve të vjedhura. Në kuadër të përcjelljes së raportit të Observatorit të shkurtit të vitit 2021, të titulluar "Së bashku jemi më të fortë: Forcimi i qëndresës së shoqërisë civile në vendet e Ballkanit Perëndimor", SEE-Obs-ja do të publikojë raporte tematike lidhur me këto tema në fillim të vitit 2022 në kuadër të një serie të titulluar "Ballkani i Qëndrueshëm".



Dialogët për qëndrueshmërinë në Ballkanin Perëndimor nxorën në dritë sfidat me të cilat përballen OSHC-të që punojnë në fushën e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

5. T'i vësh shqelmin krimit: Përdorimi i arteve marcialë për të fuqizuar rininë shqiptare.

Në kuadër të serisë sonë të bisedave me përfaqësues frymëzues të OSHC-ve në Ballkanin Perëndimor, të cilët janë duke fuqizuar qëndrueshmërinë lokale ndaj krimit të organizuar, ne biseduam me Elion Pukën, mjeshtër i arteve marcialë dhe udhëheqës i klubit "Vllaznia Taekwondo" në Shkodër të Shqipërisë.

Çfarë ju frymëzoi për të hapur klubin dhe për t'u përqendruar te rinia?

Rinia ishte ajo që më frymëzoi të hapja klubin e arteve marcialë në Shkodër. Fillova të ndjek kursin e taekwondusë në vitin 2000. Pas tri vitesh, emigrova në Itali ku vazhdova ta praktikoj këto sport. Sa herë që kthehesha në qytetin e lindjes, të rinjtë më kërkonin me zell t'u a mësoja këtë sport. Në atë kohë, gjendja ishte e vështirë. Gjeta një hapësirë të lirë në ambiente të jashtme ku arrita të organizoj një grup të vogël të rinjsh dhe ku dhashë orët e para të kursit. Ata më kërkuan të demonstroja teknikat dhe të praktikojta me ta. Ishin të etur për të mësuar gjëra të reja. Sa herë që kthehesha në Itali, ndieja se duhej të kthehesha në qytetin tim dhe të hapja një klub artesh marcialë për të rinjtë e të rejtat. Pas vitesh të tëra praktike, trajnerët në Itali më thanë se isha gati të hapja një klub timin.

Çfarë i motivon të rinjtë e të rejtat për t'u anëtarësuar në klub? Cilat janë rrethanat e tyre?

Anëtarët e klubit vijnë nga rrethanat të ndryshme dhe kanë motive të ndryshme. Disa vijnë sepse shokët dhe shoqet e tyre janë tashmë pjesë e klubit dhe i inkurajojnë që të anëtarësohen edhe ata. Të tjerët shohin artet marcialë në televizor dhe kanë dëshirë t'i provojnë vetë. Anëtarët tanë vijnë nga mjedise të ndryshme shoqërore: disa nga familje të pasura, disa nga familje të klasës së mesme dhe disa nga familje me më pak avantazhe. Kemi të rinj edhe nga komuniteti i romëve. Ne i trajtojmë të gjithë anëtarët në mënyrë të barabartë dhe mundohemi t'i përfshijmë. Jemi shumë të lumtur që kemi anëtarësi të tillë të shumëllojshme që pasqyrojnë komunitetin shkodran.

A janë disa të rinj në këtë zonë veçanërisht të cenueshëm nga krimi i organizuar?

Mendoj se arsyeja kryesore pse disa të rinj shfaqin sjellje devijuese është niveli i ulët i arsimit. Gjithashtu, mungojnë edhe mundësitë për punësim. Të rinjtë, gjithmonë e më shumë, po i drejtohen dhunës dhe krimit të organizuar. Kjo, jo vetëm që po i prish emrin qytetit tonë, por po dëmton edhe identitetin e rinisë. Si shoqëri, duhet të investojmë më shumë në arsim, duke përfshirë këtu edhe sportin. Të rinjtë kanë nevojë për më shumë mundësi për veprimtari shoqërore, kulturore dhe sportive.



Elion Puka, mjeshtër i arteve marcialë dhe drejtues i klubit "Vllaznia Taekwondo" në Shkodër, Shqipëri.

Çfarë roli luan sporti—dhe klubet si juaji—për t'u ofruar të rinjve alternativa ndaj krimit? Çfarë rëndësie ka sporti në jetën e një të riu ose të reje?

Ushtrimi i sportit i ndihmon të rinjtë të shkarkojnë energjitë negative dhe i mban larg rreziqeve si krimi dhe dhuna. Si klub, rrimë larg dhe mbajmë larg anëtarët tanë nga çdo lloj veprimtari kriminale. Klubi ynë ia ka bërë të qartë secilit anëtar që ne besojmë në punën e rëndë dhe të ndershme. Kjo qasje i ka ndihmuar nxënësit dhe studentët tanë të ushqejnë virtyte dhe t'i bashkëndajnë ato në komunitet. Gjithashtu, ne i nxisim ata që të kërkojnë rol-modele pozitive në shoqëri dhe të jenë edhe vetë modele të mira.

A i qaseni trajnimit të të rinjve dhe trajnimit të të rejeve në mënyra të ndryshme?

Ne i trajtojmë të rinjtë e të rejtat në mënyrë të barabartë. Ka qenë gjë shumë e mirë që kemi parë që numri i vajzave që bëhen pjesë e klubit tonë ka qenë në rritje. Ato po ia dalin shumë mirë. Meritë të madhe ka gruaja ime, e cila gjithashtu është trajnere dhe bashkëthemeluese e klubit. Shembulli i saj ka sfiduar mentalitetin e qytetit tonë, sipas të cilit artet marcialë dominohen nga meshkujt. Ajo, jo vetëm që është atlete dhe trajnere e shkëlqyer, por, me praninë e saj, sjell edhe shumë energji pozitive në klub. Falë saj, numri i vajzave në klub është duke u rritur. Kemi shumë histori suksesi.



Përmes taekwondusë, klubi synon të nxisë disiplinimin dhe t'i ofrojë rinisë shkodrane rol-modele pozitive.

Si rrisni vetëdijësimin rreth krimit të organizuar përmes trajnimit?

Ne kujdesemi për çdo individ që ka dëshirë të trajnohet në klubin tonë. Ne mundohemi të kuptojmë mënyrën se si mendon dhe se çfarë qëllimesh dëshiron të arrijë ai individ përmes trajnimit. Ne i shpjegojmë përfitimet që ka sporti dhe rreziqet e abuzimit, për shembull, nëse i përdor aftësitë në mënyrë joetike ose të paligjshme. Për fat të mirë, deri më tani, nuk kemi pasur asnjë rast ku sporti ynë të jetë përdorur si armë ose të jetë keqpërdorur për qëllime kriminale. Përkundrazi, artet marciale priren të forcojnë disiplinën vetjake.

A shqetësoheni ndonjëherë që, duke trajnuar meshkujt e rinj në arte marciale, ata mund të bëhen thjesht luftëtarë më të mirë në rrugë?

Disa njerëz që kanë ardhur në klubin tonë ishin hiperaktivë dhe kishin probleme me sjelljen. Këta individë të vështirë kanë nevojë për vëmendje të veçantë sepse ekspozohen lehtësisht ndaj dhunës dhe, nëse nuk trajnohen profesionalisht, mund të shkaktojnë dëm. Në këto raste—dhe ka pasur fare pak të tilla—kemi arritur me sukses t'ua kanalizojmë energjitë përmes dialogut dhe trajnimeve tek për tek. Në raste të rralla, ka pasur prej atyre që kanë hequr dorë nga klubi. Por shumica qëndrojnë. Ne punojmë me ta për të diskutuar problemet e tyre, u japim një hapësirë të sigurt ku të trajnohen dhe theksojmë rëndësinë që ka etika, disiplina dhe puna e rëndë. Të sjellësh ndryshim pozitiv në këto raste të vështira mund të çojë në krijimin e shembujve të mirë në shoqëri.

Cilat janë sfidat me të cilat përballeni ju kur merreni me anëtarët e vegjël të klubit tuaj dhe si i kapërceni ato?

Sfida jonë është të frymëzojmë tolerancë zero ndaj dhunës dhe krimit të organizuar. Kjo është arsyeja pse kemi aplikuar në "Fondin e Qëndrueshmërisë" të GI-TOC-së. Ne komunikojmë vazhdimisht me anëtarët e klubit tonë, me qëllim që ata të ndërtojnë një karakter të mirë dhe përpiqemi t'i frymëzojmë dhe motivojmë me rol-modele pozitive. Gjithashtu, i sfidojmë të na sjellin shembuj konkretë të kontributeve të tyre në shoqëri, sidomos në shkollë. I nxisim të punojnë fort për të arritur rezultate të mira në sport dhe në shkollë dhe të bëhen qytetarë konstruktivë në shoqëri.

Si i përfshijnë trajnerët tuaj mesazhet rreth fuqizimit dhe ndenjjes larg drogës dhe krimit në atë që, në fund të fundit, është kurs sporti?

Kur u shpjegojmë një teknikë ose lëvizje, ne u japim edhe mesazhe të rëndësishme lidhur me atë se si ta mbajnë trupin në formë dhe i informojmë për gjërat që e dëmtojnë trupin dhe mendjen. Pavarësisht kësaj, kjo është një fushë ku mund të përfitonim nga trajnime të mëtejshme. Gjithashtu, përpiqemi të fuqizojmë shpirtin e ekipit, si në radhët e trajnerëve ashtu edhe në radhët e nxënësve dhe studentëve. Qasja që ndjekim ne është që të nxisim gërshtimin e disiplinës me harmoninë. Së bashku, këto mund të krijojnë një energji pozitive në ekip, të fuqizojnë të rinjtë e të rejtat dhe të ndryshojnë sjelljen e personave problematikë.

A e mbështesin institucionet publike përdorimin e sportit si mënyrë për t'i mbajtur të rinjtë larg krimit?

Bashkëpunimi me institucionet publike ka qenë i dobët, por është duke u përmirësuar. Me nismën tonë personale, shpesh kemi organizuar grupe atletike dhe kemi realizuar demonstrime në ambiente të hapura për të nxitur sportin në mesin e të rinjve në ditët e festave kombëtare. Për fat të keq, përpara "Fondit të Qëndrueshmërisë", nuk jemi kontaktuar kurrë nga autoritetet lokale për të bashkëpunuar në drejtim të promovimit të rol-modeleve pozitive në shoqëri. Me këtë projekt, kemi bërë përpara dhe bashkëpunimi është duke u rritur.

Çfarë mundësish janë krijuar nga puna juaj me "Fondin e Qëndrueshmërisë"?

Ky projekt na ka dhënë mundësinë të ngremë kapacitetet e trajnerëve tanë në menaxhimin e të rinjve e të rejave që janë të ekspozuara ndaj krimit të organizuar. Në

bashkëpunim me ekspertë të ndryshëm, do të organizojmë trajnime speciale për trajnerët tanë lidhur me rreziqet që paraqet krimi i organizuar për të rinjtë dhe me shprehitë e mësimdhënies dhe komunikimit në drejtim të menaxhimit të të rinjve e të rejave që kanë probleme me sjelljen. Krahas kësaj, përmes këtij projekti, jemi duke ndërmarrë nismën për të kontaktuar me institucionet lokale me qëllim krijimin e një bashkëpunimi afatgjatë në fushën e nxitjes së modeleve pozitive për rininë dhe informimit të saj për kërcënimet që paraqet krimi i organizuar.

Ne po nënshkruajmë memorandume bashkëpunimi me shkollat e mesme në vatrat lokale të krimit, për të ofruar kurse falas me qëllim nxitjen e sportit dhe të rol-modeleve pozitive në shoqëri. Gjithashtu, kemi plane për t'u shtrirë më tej duke organizuar një konkurs të hapur për të rinjtë e të rejtat nga i gjithë vendi, ku mesazhet kundër krimit dhe dhunës do të jepen nga persona të famshëm.

MIRËNJOHJE

"Buletini i rreziqeve" është rezultat i punës së Observatorit të Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore ("SEE-Obs") të Iniciativës Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar.

SEE-Obs-ja është platformë që bashkon dhe fuqizon aktorët e shoqërisë civile në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Qëllimi i platformës është t'i mundësojë shoqërisë civile të identifikojë, analizojë dhe vendosë në hartë prirjet kriminale dhe ndikimin që ato kanë në prurjet e paligjshme financiare, qeverisje, zhvillim, marrëdhëniet ndëretnike, sigurinë dhe shtetin ligjor. SEE-Obs-ja mbështet shoqërinë civile në monitorimin që ajo u bën dinamikave kombëtare dhe prirjeve më të gjera rajonale dhe ndërkombëtare të krimit të organizuar. Platforma "SEE-Obs" u themelua si rezultat i Samitit të vitit 2018 të Vendeve të Ballkanit në Londër, në kuadër të Procesit të Berlinit.

Dëshirojmë të falënderojmë Florian Qehajën, Ivica Simonovskin dhe Fabian Zhillën për kontributet e tyre të vyera.

Shënime

- 1 Ky numër është llogaritje e përafërt, sepse të katër komunat e veriut e bojkotuan regjistrimin më të fundit të popullsisë në vitin 2011. Këto përllogaritje janë nxjerrë nga profili i komunave, i përgatitur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë në vitin 2018. OSCE, Municipal Profiles 2018 [Profilet e komunave, 2018], tetor 2018, https://www.osce.org/files/Municipal%20Profiles_2018.pdf.
- 2 GI-TOC, Zonat problematike të krimit të organizuar në vendet e Ballkanit Perëndimor. Identifikimi dhe analizimi i pikave të dobëta në zona të caktuara në një kontekst rajonal, maj 2019, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2019/05/Hotspots-Report-Albanian-13Jun1110-Web.pdf>.
- 3 International Crisis Group, Kosovo's Linchpin: Overcoming Division in Mitrovica [Pika jetike e Kosovës: Kapërcimi i ndasisë në Mitrovicë], Balkans Report No. 96, 31 Maj 2000, 3, <https://d2071andvip0wj.cloudfront.net/96-kosovo-s-lingpin-overcoming-division-in-mitrovica.pdf>.
- 4 Jozef Batora et al., Spaces and institutional logics in post-conflict settings of Mitrovica [Hapësirat dhe logjistika institucionale në kuadrin paskonfliktor të Mitrovicës], Journal of Intervention and Statebuilding, 15, 1, 114–131.
- 5 Walter Kemp, Mark Shaw dhe Arthur Boutellis, The elephant in the room: How can peace operations deal with organized crime? [Elefanti në dhomë: Si mund ta trajtojnë operacionet paqësore krimin e organizuar?], International Peace Institute, 3 qershor 2013, 46–55, https://www.ipinst.org/wp-content/uploads/2013/06/elephant_in_the_room.pdf.
- 6 Isidora Stakic dhe Maja Bjelos, The Future of Civil Protection in North of Kosovo [E ardhmja e mbrojtjes civile në veri të Kosovës], Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë dhe Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë, 4 tetor 2015, <https://www.balkansecurityplatform.org/Publications/354/The-future-of-Civil-Protection-in-North-Kosovo.shtml>.
- 7 Ivana Jeremić, An unexpected cooperation: Albanians and Serbs 'Affairs' in Kosovo [Bashkëpunimi i papritur: Aferat e shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë], Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë, 15 tetor 2021, <https://bezbednost.org/en/publication/an-unexpected-cooperation-albanians-and-serbs-affairs-in-kosovo/>.
- 8 Adelina Ahmeti dhe Kreshnik Gashi, In North Kosovo, mining for Bitcoin on 'free' electricity [Në veri të Kosovës, nxjerrja e bitkoinit me energji elektrike "falas"], BalkanInsight, 12 maj 2021, <https://balkaninsight.com/2021/05/12/in-north-kosovo-mining-for-bitcoin-on-free-electricity/>.
- 9 Dragiša Mijačić, O Fondu za razvoj severa Kosova, Kim, 30 nëntor 2020, <https://www.radiokim.net/vesti/analiza/o-fondu-za-razvoj-severa-kosova.html>.
- 10 Pobeda Srpske liste 100%, gradonačelnici u 19 opština u prvom krugu, ni u jednoj LVV, Kossev, 17 tetor 2021, <https://kossev.info/danas-su-kosovski-lokalni-izbori-biralista-se-otvaraju-u-7/>.
- 11 Od „čuvara mosta“ do međunarodne poternice: Ko je Zvonko Veselinović, BBC, 2 dhjetor 2019, <https://www.bbc.com/serbian/lat/srbija-50633650>.
- 12 Rada Trajkovići, politikaner serbe lokale, ka përsëritur pretendimet se Radoiçiçi qëndron prapa vrasjes së Ivanoviçit. Shihni: Radoiçiçi glavnoosumnjiçeni za ubistvo Olivera Ivanovića, Radio Evropa e Lirë, 23 gusht 2019, <https://www.slobodnaevropa.org/a/pristina-sud-radoiçic-ivanovic/30125833.html>.
- 13 Three Serbs arrested in Oliver Ivanovic murder investigation [Arrestohen tre serbë gjatë hetimit të vrasjes së Oliver Ivanoviçit], EU-OCS, 23 nëntor 2018, <https://eu-ocs.com/three-serbs-arrested-in-oliver-ivanovic-murder-investigation/>.
- 14 Pristina court withdraws warrant for Kosovo Serb List official [Gjykata e Prishtinës tërheq urdhër-arrestin për zyrtarin e Listës Serbe në Kosovë], Kossev, 1 mars 2021, <https://rs.n1info.com/english/news/pristina-court-withdraws-warrant-for-kosovo-serb-list-official/>.
- 15 US Department of the Treasury, Treasury targets corruption networks linked to transnational organized crime [Thesari vë në shënjestër rrjetet e korrupsionit të lidhura me krimin e organizuar ndërkombëtar], 8 dhjetor 2021, <https://home.treasury.gov/news/press-releases/jy0519>.
- 16 Intervistë me kryeministrin Kurti, e datës 7 nëntor 2021, shihni: Kurti: Beogradi dëshiron ta ketë një shtet në Kosovë, s'mund të ketë Asociacion, pike, Gazeta Express, 7 nëntor 2021, <https://www.gazetaexpress.com/kurti-nuk-mund-te-kete-asociacion-mbi-baza-etnike-pike/>.
- 17 DEKLARATA/ Policia e Kosovës për tensionet në Mitrovicë: Grupet kriminale kanë qëlluar me armë dhe granata, janë plagosur 6 efektivë, Dritehije, 13 tetor 2021, <https://www.dritehije.com/2021/10/13/deklarata-policia-e-kosoves-per-tensionet-ne-mitrovice-grupet-kriminale-kan-qelluar-me-arme-dhe-granata-jane-plagosur-6-efektiv/>.
- 18 Për më shumë hollësi, shihni deklaratën e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, z. Samedin Mehmeti, Drejtori i Policisë: 10 policë u lënduan në Mitrovicën Veriore gjatë aksionit kundër kontrabandimit me mallra, Shqip.com, nëntor 2021, <https://shqip.com/drejtori-i-policise-10-zyrtare-policore-u-lenduan-ne-mitrovicen-veriore-gjate-aksionitkunder-kontrabandimit-me-mallra/>.
- 19 Këto njësi të ndërhyrjes speciale quhen "Njësi Speciale Operative" (NJSO). NJSO-të njihen gjerësisht në medien serbe me termin "ROSU": një akronim që i përket periudhës kur Kosova ishte nën administrimin ndërkombëtar, kur forcat speciale quheshin "Rapid Operational Support Unit" (njësia e shpejtë e mbështetjes operative). Që prej asaj kohe, kjo njësi është riorganizuar. Pavarësisht kësaj, ROSU-ja vazhdon të përfaqësojë një "forcë frike" në sytë e shumë serbëve në veri të Kosovës, ku ngjyresa negative e njësisë është bërë pjesë thelbësore e gjuhës së përditshme të politikanëve serbë dhe e narrativës së gazetave të medieve serbe.
- 20 Për më shumë hollësi, shihni deklaratën e z. Besart Ahmeti, komandant i njësive operative NJSO, Komandanti i Njësive Speciale, Besart Ahmeti tregon se si u plagos në aksionin kundër kontrabandës në veri, Telegrafi, 3 nëntor 2021, <https://telegrafi.com/komandanti-njesise-speciale-besart-ahmeti-tregon-se-si-u-plagos-ne-aksionin-kunder-kontrabandes-ne-veri/>.
- 21 Bekim Shehu, BE reagon për tensionet në veri të Kosovës, Deutsche Welle, 13 tetor 2021, <https://www.dw.com/sq/be-reagon-p%C3%ABr-tensionet-n%C3%AB-veri-t%C3%AB-kosov%C3%ABs/a-59497238>.
- 22 Për të mësuar më shumë lidhur me takimin e Raskës, shihni: Vuçiç sa Srbima u Raški: Čuvaćemo mir, ako krene nasilje zaštitite narod, N1, 13 tetor 2021, <https://rs.n1info.com/vesti/vucic-kosovo-sever-policija-akcija-srbi-albanci/>. Ndërkohë që takimi transmetojnë drejtpërdrejt, Radoiçiçi e bëri ndërhyrjen e tij në mënyrë publike, së bashku me anëtarët e tjerë të Listës Serbe.
- 23 Nikola Mitkovic, Open Balkan: Who benefits from it? [Ballkani i Hapur: Kush përfiton prej tij?], CGTN, 31 korrik 2021, <https://news.cgtn.com/news/2021-07-31/Open-Balkan-Who-benefits-from-it--12lawyWuzGo/index.html>.
- 24 RSE: Za vladu Kosova Open Balkan je inicijativa bez vizije, Danas, 29 korrik 2021, <https://www.danas.rs/politika/rse-za-vladu-kosova-open-balkan-je-inicijativa-bez-vizije/>.
- 25 Këto tri dokumente janë: "Memorandumi i mirëkuptimit dhe bashkëpunimit për lehtësimin e importit, eksportit dhe lëvizjes së mallrave në Ballkanin Perëndimor", "Memorandumi për qasjen e lirë në tregun e punës" dhe "Marrëveshja për bashkëpunim në mbrojtjen nga fatkeqësitë".
- 26 Sinisa Jakov Marusic, Balkan 'Mini-Schengen' leaders eye open borders by 2023 [Liderët e "minishengenit" ballkanik

- synojnë hapjen e kufijve para vitit 2023], BalkanInsight, 29 korrik 2021, <https://balkaninsight.com/2021/07/29/balkan-mini-schengen-leaders-eye-open-borders-by-2023/>.
- 27 Kodin për Kufijtë e Shengenit mund ta gjeni në adresën: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32016R0399&from=EN>.
 - 28 Leonard Fox, Kanuni i Lekë Dukagjini. New York: Gjonlekaj Publishing Company, 1989.
 - 29 Tanya Mangalakova, The Kanun, the present day Albania, Kosovo and Montenegro [Kanuni: Shqipëria, Kosova dhe Mali i Zi i ditëve tona], International Centre for Minority Studies and Intercultural Relations (IMIR), 2004, <https://core.ac.uk/download/pdf/11870995.pdf>.
 - 30 Arben Cara dhe Mimoza Margjeka, Kanun of Leke Dukagjini, Customary law of Northern Albania [Kanuni i Lekë Dukagjinit: E drejta zakonore e Shqipërisë së veriut], European Scientific Journal, 2015, 174-186.
 - 31 Margaret Hasluck, The Unwritten Law in Albania [Ligji i pashkruar në Shqipëri]. New York: Cambridge University Press, 1954.
 - 32 Mirjona Sadiku, A Tradition of honor, hospitality and blood feuds: Exploring the Kanun customary law in contemporary Albania [Tradita e nderit, mikpritjes dhe gjakmarrjes: Eksplorimi i të drejtës zakonore të Kanunit në Shqipërinë bashkëkohore], Balkan Social Science Review, 2014, 3, 93-113.
 - 33 Sandra F Joireman, Aiming for certainty: the Kanun, blood feuds and the ascertainment of customary law [Të kërkosh siguri: Kanuni, gjakmarrja dhe vërtetimi i së drejtës zakonore], The Journal of Legal Pluralism and Unofficial Law, 2014, 46, 2, 235-248.
 - 34 Vincenzo Mattei, Albania: The dark shadow of tradition and blood feuds, an ancient code of retaliation is forcing generations of Albanians into their own private prisons [Shqipëria: Hija e errët e traditës dhe gjakmarrjes, kodi i vjetër i hakmarrjes i detyron brezat e shqiptarëve të futen me forcë në burgjet e tyre private], Al Jazeera, 14 maj 2016, <https://www.aljazeera.com/features/2016/5/14/albania-the-dark-shadow-of-tradition-and-blood-feuds>.
 - 35 Fabian Zhilla, Organised crime and judicial corruption: Are customary norms playing any role? [Krimi i organizuar dhe korrupsioni në gjyqësor: A po luajnë ndonjë rol normat e së drejtës zakonore?], Journal of Financial Crime, 18, 4, 387-404.
 - 36 Po aty.
 - 37 Andrew Hosken dhe Albana Kasapi, The children trapped by Albania's blood feuds [Fëmijët e zënë në kurth nga gjakmarrja në Shqipëri], BBC radio 4, 12 nëntor 2017, <https://www.bbc.com/news/world-europe-41901300>.
 - 38 Intervista të realizuara me burime anonime, nëntor 2021, Shkodër.
 - 39 Si nisën përplasjet e fiseve Bajri- Lici që solli 8 të vrarë në 15 muaj, Panorama, 29 prill 2019, <http://www.panorama.com.al/si-nisen-perplasjet-e-fiseve-bajri-lici-qe-solli-8-te-vrare-ne-15-muaj/>.
 - 40 Fabian Zhilla, Organised crime and judicial corruption: Are customary norms playing any role? [Krimi i organizuar dhe korrupsioni në gjyqësor: A po luajnë ndonjë rol normat e së drejtës zakonore?], Journal of Financial Crime, 18, 4, 387-404.
 - 41 Operazione Colomba, Descriptive document on the phenomenon of 'hakmarrja' and 'gjakmarrja' to raise awareness among albanian and international institutions (3rd edition) [Studim përshkrimor i dukurisë së "hakmarrjes" dhe "gjakmarrjes" për rritjen e vetëdijes në radhët e institucioneve shqiptare dhe ndërkombëtare (botimi i 3-të)], dhjetor 2017, https://www.operazionecolomba.it/docs/Report_ING-2017.pdf; Shihni: <https://shtetiweb.org/2012/09/25/qarku-i-shkodres/>.
 - 42 Dan Bilefsky, In Albanian feuds, isolation engulfs families [Në gjakmarrjen shqiptare: ngujimi gllabëron familjet], New York Times, 10 korrik 2008, <https://www.nytimes.com/2008/07/10/world/europe/10feuds.html>.
 - 43 Operazione Colomba, Descriptive document on the phenomenon of 'hakmarrja' and 'gjakmarrja' to raise awareness among albanian and international institutions (3rd edition) [Studim përshkrimor i dukurisë së "hakmarrjes" dhe "gjakmarrjes" për rritjen e vetëdijes në radhët e institucioneve shqiptare dhe ndërkombëtare (botimi i 3-të)], dhjetor 2017, https://www.operazionecolomba.it/docs/Report_ING-2017.pdf.
 - 44 Në vitin 2014, kryetari i Asamblesë Kombëtare të Misionarëve të Pajtimit Mbarëkombëtar në Durrës, Ndrec Prenga, dhe dy persona të tjerë u arrestuan për lëshimin e dëshmimeve të rreme për 4 000 euro. Katër mijë euro është pazari për një dokument gjakmarrje, Gazeta Shqip, 21 shkurt 2014, <http://www.arkivalajmeve.com/Kater-mije-euro-eshte-pazari-per-nje-dokument-gjakmarrje.1047530717/>.
 - 45 Kodi Penal i Shqipërisë, i disponueshëm në: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2020/11/Ligj_nr_7895_Kodi_penal_i_ndryshuar_2020.pdf.
 - 46 Plani kombëtar i veprimt nr. 1277 "Për parandalimin, gjurmimin dhe luftimin e veprave penale të vrasjes për gjakmarrje", 24 tetor 2012.
 - 47 Shihni raportin afatmesëm të Shqipërisë për zbatimin e rekomandimeve të marra gjatë ciklit të dytë të Rishikimit Periodik Universal, mars 2017, 8.
 - 48 Rezolutë "Për parandalimin e fenomenit të gjakmarrjes në Shqipëri", Kuvendi i Shqipërisë, 5 mars 2015, <https://qbz.gov.al/eli/rezolute/2015/03/05/38-1/3fd74c03-ecea-42fd-ab72-cea6d6feb97c?q=gjakmarrja>.
 - 49 Raport i veçantë i Avokatit të Popullit, Mbi Fenomenin e Gjakmarrjes në Shqipëri, dhjetor 2015, <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/RAPORT%20I%20VE%20C3%87ANT%20C3%8B%20%20nr.%20%20per%20gjakmarrjen.pdf>.
 - 50 Raporti për Shqipërinë 2018, Dokumenti i Punës së Stafit të Komisionit të BE-së (2018) 151 përfundimtar, 17 prill 2018, 26, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/20180417-albania-report.pdf>.
 - 51 Raport mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2020, Prokuroria e Përgjithshme, <https://pp.gov.al/Dokumente/>.
 - 52 Raport mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2018, Prokuroria e Përgjithshme, <https://www.pp.gov.al/Dokumente/?ser=1209&rpp=3&msv=>.

"Buletinet e rreziqeve" janë publikime periodike të vëzhguesve tanë rajonalë, të cilët mbështeten në rrjetet e shoqërisë civile për të siguruar të dhëna të reja dhe për të vënë në kontekst prirjet që kanë të bëjnë me rrjetet e krimit të organizuar, tregtinë e paligjshme dhe reagimin shtetëror ndaj tyre. Nëse dëshironi të abonoheni për numrat e ardhshëm të "Buletinit të rreziqeve", ju lutemi të regjistroheni [këtu](#) ose të na dërgoni një email në adresën: Kristina.Amerhauser@globalinitiative.net.

MBI "INCIATIVËN GLOBALE"

Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar është një rrjet mbarëbotëror, i përbërë nga 500 ekspertë nga e gjithë bota. "Iniciativa Globale" ofron një platformë për të nxitur një debat më të gjerë dhe qasje inovatore, duke krijuar kështu një bazë të shëndoshë për hartimin e një strategjie globale gjithëpërfshirëse kundër krimit të organizuar.

www.globalinitiative.net

Ky botim u bë i mundur falë përkrahjes financiare të Fondit të Mbretërisë së Bashkuar për Konfliktin, Stabilitetin dhe Sigurinë. Lënda e botimit është përgjegjësi vetëm e GI-TOC-së dhe nuk pasqyron patjetër pikëpamjet e Mbretërisë së Bashkuar.



**GLOBAL
INITIATIVE**
AGAINST TRANSNATIONAL
ORGANIZED CRIME